

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P No. 02/2009

01 korrik 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi i EULEX-it Charles L. Smith, si kryetar i trupit gjykues, Gjykatësit e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Klaus Jung, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Zane Ratniece, si procesmbajtëse, në **LËNDËN PENALE**

kundër: **A. B.**, i lindur më _____ në fshatin _____, komuna e _____

I akuzuar për: veprë penale të **Tentim Vrasjes** në kundërshtim me Nenin 146 lexuar me Nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës, sipas Aktakuzës së Prokurorit Publik të Qarkut Shyqyri Syta, PP Nr. 103/2008, të datës 09 janar 2009, dhe të ngritur në Shkrimore të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 09 janar 2009;

pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur për publik më 28 dhe 30 qershor 2010, të gjitha në praninë e të Akuzuarit **A. B.**, Avokatit të tij Mbrojtës **A. C.**, Prokurores Publike të EULEX-it Neeta Amin, Palës së Dëmtuar **A. D.**, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palës së Dëmtuar **A. F.**, nënës së Akuzuarit **A. G.** (përveç seancës së 28 qershorit 2010 kur nëna e të Akuzuarit nuk ishte e pranishme);

pas këshillimit dhe votimit nga trupi gjykues të mbajtur më 01 korrik 2010;

sipas Seksionit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34 'Mbi Procedurën Penale që Përfshinë Kryerësit me Çrregullime Mendore', ka shpallur publikisht dhe në praninë e të akuzuarit **A. B.**, Avokatit të tij Mbrojtës **A. C.**, Prokurores Publike të EULEX-it Neeta Amin, Palës së Dëmtuar **A. D.**, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palës së Dëmtuar **A. F.**, nënës së të Akuzuarit **A. G.**, siç vijon

AKTVENDIM

A. B., i biri i **A. H.**, dhe **A. G.**, i lindur më _____ në fshatin _____, Komuna e _____, Shqiptar Kosovar, vendbanimi i fundit i njohur _____



fshati , komuna e , të mbaruar shkollën e mesme, i martuar, me katër fëmijë, pa dënime të mëparshme, në paraburgim nga 18 shtatori 2008, është

përcaktuar që ka kryer veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës; sepse më 18 shtator 2008, rreth orës 10:00, në fshatin S, , në godinën e qendrës mjekësore të fshatit, A, B, fizikisht ka sulmuar gruan e tij - Palën e Dëmtuar A, D, , duke e goditur në kokë dhe fytyrë, e ka hedhur në tokë , ia ka mbyllur gojën dhe pastaj ka nxjerrë një litar nga xhepi i tij dhe e ka lidhur atë rreth qafës së Palës së Dëmtuar derisa ajo ishte e shtrirë në tokë, deri kur A, B, ka qenë i sigurt që i ka privuar jetën Palës së Dëmtuar;

dhe është

përcaktuar që ka kryer veprën penale të përmendur të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, në gjendje të paaftësisë mendore; sepse në kohën e kryerjes së veprës penale, më 18 shtator 2008, A, B, ka vuajtur nga çrregullimi deluzional, i cili ka ndikuar në funksionimin e tij mendor kështu që ai nuk ka qenë i aftë të kuptojë dhe të kontrollojë veprimet e tij, apo të kuptojë që ai ishte duke kryer një veprë penale;


prandaj është

penalisht jo përgjegjës për veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, sipas Nenit 11 Paragrafi (1) dhe nenit 12 Paragrafi (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës;

dhe i është

shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, sipas Nenit 5 dhe Nenit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34 'Mbi Procedurën Penale që Përfshin Kryerësit me Çrregullime Mendore'; masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri do të zbatohet, siç vijon:

- Masa e trajtimit të detyrueshëm të zbatohet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë;
- A, B, i kërkohet që të lajmërohet për trajtim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë më 01 korrik 2010;
- Deri më 01 shtator 2010, A, B, të kryejë trajtim ambulator në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, me mbikëqyrje të rregullt dhe të afërt nga psikiatri;



- Duke filluar nga 01 shtatori 2010 *A, B,* ë pranohet për trajtim, i shtrirë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë.

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Sipas Nenit 103 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, shpenzimet e procedurës penale nën Nenin 99 Paragrafi (2), Nënparagrafi 1 deri te 5 të Kodit, shpenzimet e domosdoshme të të pandehurit dhe pagesa e shpenzimeve të domosdoshme të Avokatit Mbrojtës, gjithashtu shpenzimet e interpretimit dhe përkthimit do të paguhen nga burimet e buxhetit.

ARSYETIMI

I. HISTORIA E PROCEDURËS

1.1. Aktakuza

Më 09 janar 2009, Shyqyri Sylja, Prokuror Publik i Qarkut për Mitrovicë ka ngritur Aktakuzën PP. Nr. 103/08, të datës 09 janar 2009, në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

Sipas Aktakuzës PP. Nr. 103/08, i Akuzuari *A, B,* është akuzuar për veprë penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të Kodit Penal të Kosovës (KPK).

Akuza e Tentim Vrasjes ndaj të Akuzuarit është bazuar në pohimet faktike siç vijojnë:

“Më 18 shtator 2008, rreth orës 10:00, në fshatin *S,* në godinën e qendrës Mjekësore të fshatit, *A, B,* me qëllim, ka filluar kryerjen e veprës penale të Vrasjes të cilën nuk e ka kompletuar, pas një mosmarrëveshjeje verbale dhe duke u bazuar në motive xhelozie, ai ka shkuar te qendra mjekësore ku viktima, *A, D,* gruaja e të pandehurit, punon dhe i ka thënë këto fjalë: “Shkruaj emrat e të gjithë burrave me të cilët ke pasur afëra, ma bëj një kafë dhe unë do të shkoj”; dhe kur viktima ka refuzuar ta bëjë këtë, *A, B,* fizikisht e ka sulmuar gruan e tij *A, D,* duke e grushtuar në kokë dhe fytyrë, e ka hedhur në tokë, ia ka mbyllur gojën dhe nga xhepi e ka nxjerrë një litar të cilin e ka lidhur rreth qafës së saj derisa ajo ishte në tokë, dhe duke e shtrënguar litarin dhe duke qenë i sigurt që ai e kishte ngulfatur atë dhe



kështu e kishte e privuar nga jeta, ai është ngritur nga godina dhe është takuar me dëshmitarin *F. B.* të cilit i kishte thënë: 'E kam ekzekutuar gruan time, ngutu thirre policinë dhe emergjencën'; dhe ndërkohë *F. B.* ka arritur te viktima dhe i ka dhënë ndihmën e parë duke e larguar litarin nga qafa e saj kështu që vepra ka mbetur në tentativë.¹

1.2. Konfirmimi i Aktakuzës

Më 11 janar 2010, Gjykatësi për Konfirmim Xhevdet Abazi ka lëshuar aktvendimin për konfirmimin e Aktakuzës PP. Nr. 103/08, të datës 09 janar 2009.

II. KOMPETENCA E GJYKATËS

2.1. Kompetenca lëndore dhe territoriale

Sipas Nenit 23 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), një gjykatë e qarkut do të ketë kompetencë për të gjykuar në shkallën e parë një vepër penale të dënueshme me më së paku pesë vjet apo burgim afatgjatë.

Vepra penale e ngarkuar e Tentim Vrasjes, sipas Nenit 146 të lexuar me Nenin 20 të KPK-së, lejon burgim prej pesë vjetësh .


Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka kompetencën lëndore mbi këtë lëndë.

Vepra e ngarkuar penale e Tentim Vrasjes është pohuar të jetë kryer në fshatin Samadrexhë,² që gjendet në komunën e Vushtrisë.

Prandaj, sipas Nenit 27 Paragrafi (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka kompetencë territoriale mbi këtë lëndë.

¹ Shiko aktakuzën PP. Nr. 103/08 të datës 09 Janar 2009, (përkthimi në Gjuhën Angleze)

² Ibid



2.2. *Kompetenca e Gjykatësve të EULEX-it.*

Neni 3 Paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-053 'Mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë' thotë që në rastet e kompetencave suplementare, Gjykatësit e EULEX-it mund të marrin përsipër një lëndë me caktimin nga Presidenti i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it. Më 15 shkurt 2010, Presidenti i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it, pas kërkesës nga Prokurori i EULEX-it, vendosi t'i caktojë në lëndë gjykatësit e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

III. **LIGJI I APLIKUESHËM**

3.1. *E drejta materiale e aplikueshme*


Vepra e ngarkuar penale e Tentim Vrasjes pohohet që është kryer më 18 shtator 2008. E drejta materiale e aplikueshme në këtë lëndë është ajo në fuqi në atë kohë, kur është kryer vepra penale.

I Akuzuari, sipas Aktakuzës PP. Nr. 103/08, është akuzuar sipas Kodit Penal të Kosovës (KPK). KPK është në fuqi nga 06 janari 2009, që është *pasi* i Akuzuari supozohet të ketë kryer veprën e ngarkuar penale. Në kohën kur i Akuzuari pohohet që ka kryer veprën penale të Tentim Vrasjes, më 18 shtator 2008, në fuqi ka qenë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i miratuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25, që ka hyrë në fuqi më 06 Prill 2004 (KPPK). KPK në krahasim me KPPK nuk është më i favorshëm në këtë rast të veçantë.

Prandaj, edhe pse Aktakuza PP. Nr. 103/08 ka akuzuar të Akuzuarin sipas KPK-së, ligji i aplikueshëm është KPPK.

Ligji procedural i aplikueshëm

Ligji procedural i aplikueshëm është ai që është në fuqi në kohën kur kryhet procedura. Në kohën e procedurës gjyqësore në fuqi ka qenë Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK). Prandaj, gjykata ka ndjekur procedurën sipas KPPK-së.



3.2. Ligji i veçantë në procedurën penale që përfshin kryerësit me çrregullime mendore

Në dosjen e lëndës gjykata ka identifikuar raporte mjekësore për të Akuzuarin *A. B.*, (të përshkruar në detaje më poshtë), që parashikojnë për dyshimin që i Akuzuari vuan nga një çrregullim mendor. Prandaj, gjykata ka marrë parasysh po ashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/34 'Mbi Procedurën Penale që Përfshin Kryerësit me Çrregullime Mendore'.

IV. PËRMBLEDHJE E DËSHMIVE TË PARAQITURA

4.1. Personat siç vijojnë janë marrë në pyetje si dëshmitarë gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor:

- 1) Pala e Dëmtuar *A. D.*, më 28 qershor 2010;
- 2) Dëshmitari Ekspert Ass. Dr. _____ psikiatër, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, më 30 qershor 2010;
- 3) Dëshmitari Ekspert *M. M.*, neuropsikiatër, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, më 30 qershor 2010.

4.2. Dokumentet siç vijojnë janë parashtruar të përdoren si dëshmi nga Prokurori Publik i EULEX-it, dhe janë konsideruar si të lexuara duke u bazuar në pëlqimin e palëve.

- 1) Deklarata e *A. D.* te Prokurori Publik i Qarkut Xhevdet Bislimi, e datës 22 dhjetor 2008;
- 2) Intervista e *A. B.*, para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr. 2008 _____, e datës 19 shtator 2008;
- 3) Intervista e dëshmitares *G. G.*, para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr. 2008 _____, e datës 18 shtator 2008;
- 4) Raporti Identifikues Forenzik, Njësia Forenzike Regjionale, Mitrovicë, dosja e rastit nr. _____, SHPK _____, i datës 18 shtator 2008;
- 5) Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për _____, Raporti i Ekspertizës i dërguar Gjykatësës Emine Mustafa, raport i përpiluar në bazë të urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës të datës 13 tetor 2008;
- 6) Raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, i datës 05 mars 2010, ekspertizë e administruar në bazë të urdhrit të gjykatësit Ferit Osmani, i datës 09 shkurt 2010;



- 7) Raport shtesë i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, nr. 155, i datës 04 qershor 2010, ekspertizë e kryer në bazë të urdhrit të kryetarit të trupit gjykues gjykatësit të EULEX-it Charles L. Smith,III, i datës 17 maj 2010;
 - 8) Raporti Psikologjik për *A. B.*, nr. 867, i datës 20 nëntor 2008;
 - 9) Fletëlëshimi për *A. D.*, nr. i regj. , nga Qendra Klinike Universitare, Klinika e Neurokirurgjisë;
 - 10) Fletëlëshimi për *A. B.*, nr. i regj. nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Neuropsikiatrike;
 - 11) Fletëlëshimi për *A. B.*, nr. i regj. , nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Departamenti i Psikiatrisë;
 - 12) Raporti për Komisionin Mjekësor në lidhje me *A. B.*, numri i kartës , nr. i regj. , i datës 05 dhjetor 2008;
 - 13) Raporti i hetimit të vendit të ngjarjes, i datës 19 shtator 2008;
 - 14) Raporti Fillestar/i Incidentit, nr. i rastit 2008- , nr. i referencës 2008- , i datës 18 shtator 2008;
 - 15) Incizimi i Vendit të Ngjarjes, Skica, nga Oficeri Mentor Imeri;
 - 16) Albumi Fotografik, nr. , i datës 18 shtator 2008;
- 4.3. Nga dëshmitë e përmendura më lart, që janë marrë parasysh si të lexuara në bazë të pajtimit nga palët, dëshmitë vijuese janë mbledhur nga gjykata:
- 1) Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, , i datës 04 Qershor 2010, ekspertiza e kryer në bazë të urdhrit të kryetarit të trupit gjykues Gjykatësit të EULEX-it Charles L. Smith,III, të datës 17 maj 2010;
 - 2) Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, , Raporti i Ekspertizës dërguar gjykatëses Emine Mustafa, raport i përpiluar në bazë të urdhrit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës i datës 13 tetor 2008;
 - 3) Raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, , i datës 05 mars 2010, ekspertizë e kryer në bazë të urdhrit të gjykatësit Ferit Osmani, të datës 09 shkurt 2010.



V. VLERËSIMI I DËSHMIVE TË PARAQITURA

5.1. Historia mjekësore e të Akuzuarit dhe aftësia për të qëndruar në gjykim

Provat në dosjen e lëndës kanë ofruar dyshimin që i Akuzuari *A.B.* vuan nga një çrregullim mendor:

- Raporti i Komisionit Mjekësor sa i përket *A.B.*, nr. i kartës _____, nr. i regj. _____, i datës 05 dhjetor 1989, pohonte që *A.B.* ka qenë në Klinikën Neuropsikiatrike në Prishtinë dy herë: nga 11 maji 1989 deri më 26 qershor 1989 dhe nga 08 shtatori 1989 deri më 20 tetor 1989. Diagnoza ishte dhënë si _____
- Fletëlëshimi për *A.B.*, nr. i regj. _____, nga Qendra Klinike Universitare, Klinika Neuropsikiatrike, vërtetonte që i Akuzuari ka qenë në Klinikë nga 16 gushti 2000 deri më 28 gusht 2000.
- Fletëlëshimi për *A.B.*, nr. i regj. _____, nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Departamenti i Psikiatrisë, thotë që i Akuzuari ka qenë në klinikë nga 12 dhjetori 2007 deri më 15 dhjetor 2007.
- Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare, i përpiluar bazuar në urdhrin e gjykatës të datës 13 tetor 2008, thotë që i Akuzuari 'është trajtuar me vite për çrregullim psikiatrik, i cili është shfaqur kronikisht, i përshkruar në episode të lehtësimit por edhe të rëndimit, varësisht nëse terapia është përdorë apo jo'.

Dëshmitë e lartpërmendura sugjerojnë që gjendja mendore e të Akuzuarit duhet të ekzaminohet siç duhet nga gjykata.

Më 09 shkurt 2010, gjykata, sipas Seksionit 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34, ka urdhëruar ekzaminimin psikiatrik të të Akuzuarit. Raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i datës 05 mars 2010, në vijim të urdhrin të gjykatës, thotë që *A.B.* vuan nga çrregullimi deluzional F22.0 ICD-10; çrregullimi deluzional është me zhvillim dhe karakter kronik.

Për të qartësuar tutje gjendjen mendore të të Akuzuarit, më 17 maj 2010, gjykata, sipas Seksionit 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34, ka urdhëruar edhe një ekzaminim të të Akuzuarit. Gjykata, poashtu, ka pyetur sa i përket aftësisë së Akuzuarit që t'i qëndrojë gjykimit. Të gjeturat e ekspertëve të përpiluara në një Raport Shtesë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A.B.*, nr. _____, të datës 04 qershor 2010, kanë konfirmuar që *A.B.* vuan nga çrregullimi deluzional. Sa i përket aftësisë së të



akuzuarit që t'i bëjë ballë gjykimit, konkludimi i ekspertëve ishte që i Akuzuari mund t'i qëndrojë gjykimit. Është cekur po ashtu që i Akuzuari është i aftë t'i kuptojë akuzat ndaj tij dhe është i aftë të konsultohet me avokatin e tij mbrojtës, megjithatë, ai mund të japë përgjigje të paarsyeshme.

Duke u bazuar në Raportin Shtesë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, nr. , të datës 04 qershor 2010, gjykata në shqyrtimin gjyqësor më 28 qershor 2010, sipas Seksionit 8.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34, ka vendosur që i Akuzuari është i aftë t'i qëndrojë gjykimit.

5.2. Gjetjet Faktike

5.2.1. Pranimi i fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, më 28 qershor 2010, të Akuzuarit, sipas Nenit 358 Paragrafi (1) të KPPK-së, i është dhënë mundësia që të deklarohej fajtor apo i pafajshëm. Së pari, i Akuzuari vullnetarisht tha që deklarohej 'pjesërisht fajtor'³. Të akuzuarit, pastaj, iu dha mundësia ta konsultojë Avokatin e tij Mbrojtës *A. C.* sa i përket deklaramit të tij. Pas konsultimit me Avokatin Mbrojtës, *A. B.* vullnetarisht konfirmoi se deklarohej fajtor për akuzën e Tentim Vrasjes. *A. B.*, poashtu, konfirmoi që e kupton se me deklaramin fajtor ai pajtohet që ka tentuar ta privojë nga jeta gruan e tij, dhe tentim do të thotë që ai nuk ka pasur sukses. *A. B.*, poashtu, pranoi që ai kishte kuptuar që atij i takon gjykim i plotë nëse deklarohej 'i pafajshëm'⁴


5.2.2. Dëshmitë që mbështesin pranimin e fajësisë

Deklaratat e dëshmitarëve

a. *A. D.*, Pala e Dëmtuar, ka dëshmuar para Prokurorit Publik të Qarkut Xhevdet Bislimi më 22 dhjetor 2008 që në ditën kritike, para orës 08:00, ajo ishte bërë gati të shkojë në punë dhe është larguar nga shtëpia. Rugës për në punë *A. D.* ka takuar burrin e saj *A. B.* Ai ka shkuar me gruan e tij *A. D.* te vendi i saj i punës, qendra e mjekësisë në fshatin *S.* *A. B.* kërkoi nga

³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 28 Qershor 2010, f.5 (Procesverbali në gjuhën angleze)

⁴ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 28 Qershor 2010, f.5 (Procesverbali në gjuhën angleze)



gruaja e tij nëse ai mund të pinte një kafe me të. Pra, menjëherë pasi **A. D.** kishte hyrë në qendrën e mjekësisë ajo kishte marrë xhezven për të përgatitur kafën. Derisa ishte duke përgatitur kafën, **A. B.** ishte i ulur në një karrige. **A. D.** ishte duke hapur derën e dollapit, dhe nuk e din se çka ka ndodhur, mirëpo ajo është alivanosur dhe ka humbur vetëdijen deri sa kanë arritur në Klinikë në Prishtinë. Djali i saj ishte afër saj në klinikë dhe i ka thënë asaj që janë në klinikë në Prishtinë. **A. D.** kishte kanilla në duart e saja, lëndime në anën e majtë dhe të djathtë të kokës, në shpinë, kishte të thyer një asht. Pala e Dëmtuar po ashtu ka parë shenja të litarit në fytyrë e saj.⁵

Po ashtu i Akuzuari **A. B.** një ditë pas incidentit, më 19 shtator 2008, ka dëshmuar para Shërbimit Policor të Kosovës, që në mëngjesin e 18 shtatorit 2008, ai është takuar me gruan e tij **A. D.** derisa ajo ishte duke ecur për në punë.

A. B. e ka shoqëruar **A. D.** deri te vendi i saj i punës, qendra mjekësore në fshatin **S.** Para kësaj ai kishte marrë një kaçavidë dhe kishte gjetur një copë litar rreth një (1) metër të gjatë. I Akuzuari ka dëshmuar që kishte marrë kaçavidën dhe litarin pasi planikonte ta frikësojë gruan e tij, që t'ia vendosë litarin rreth qafës dhe ta përdorë kaçavidën për të shtrënguar litarin. Në këtë mënyrë **A. B.** donte ta detyronte gruan e tij t'i tregojë emrat e meshkujve me të cilët ajo ka pasur afëri në Kosovë dhe në Gjermani. Kështu që, pasi ai dhe gruaja e tij kishin hyrë në qendrën mjekësore, ai kishte kërkuar nga gruaja e tij të shkruajë emrat e të gjithë meshkujve me të cilët ajo kishte pasur afëri, pas kësaj të bëjë një kafe për të dhe ai do të shkonte në shtëpi. Pala e Dëmtuar kishte refuzuar të shkruante emrat. **A. B.** e kishte qëlluar me shuplakë në qafë, e kishte grushtuar në buzë dhe kështu pala e dëmtuar kishte filluar gjakderdhjen në tokë, kishte filluar të bërtasë, dhe **A. B.** ia mbylli gojën, nxori litarin nga xhepi i tij, ia vendosi litarin rreth qafës së saj dhe e shtrëngoi. I Akuzuari ka dëshmuar në Shërbimin Policor të Kosovës dhe ka thënë që kur ka parë barkun e gruas së tij duke lëvizur ai e kishte lëshuar atë dhe kishte ikur nga qendra mjekësore.⁶

G. G. në Intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës më 18 shtator 2008 konfirmon deklaratën e Palës së Dëmtuar duke dëshmuar që në mëngjesin e 18 shtatorit 2008 ajo kishte gjetur kolegen e saj **A. D.** në tokë në qendrën mjekësore në fshatin **S.** Në Intervistën para Shërbimit Policor të Kosovës më 18 shtator, **G. G.** ka thënë që në mëngjesin e 18 shtatorit 2008 **G. G.** i ka ardhur në qendrën mjekësore në fshatin **S.** Ajo kishte hetuar diçka njolla gjaku dhe, kur kishte hapur derën, ajo

⁵ Deklarata e **A. B.** te Prokurori Publik i Qarkut Xhevdet Bislimi, e datës 22 dhjetor 2008

⁶ Intervista e **A. B.** para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr. 2008-19 Shtator 2008, faqe 3 (përkthimi Anglisht)



kishte parë *A. D.* të shtirë në tokë. *G. G.* ka bërë titur, dhe *A. D.* ka lëvizur kokën, mirëpo nuk kishte mundur të hapte sytë, fytyra i ishte e enjtur dhe e nxirë. *G. G.* thirri emergjencën. Pastaj *F. B.* ka ardhur dhe sipas tij i dyshuari për këtë ishte burri i Palës së Dëmtuar, *A. B.*⁷

Sa i përket dëshmitarit *F. B.*, të cilin e referon *G. G.* në deklaratën e përmendur më lart, është shënuar që dëshmia e *F. B.* është e përfshirë në Procesverbalin e Dëgjimit të Dëshmitarit, të datës 22 dhjetor 2008, para Prokurorit Publik të Qarkut Xhevdet Bislimit. Procesverbali i është dorëzuar gjykatës nga Prokurori Publik i EULEX-it, dhe ai poashtu është referuar në aktakuzën PP. Nr. 103/08. Megjithatë, Prokurori Publik i EULEX-it gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor nuk e ka marrë parasysh dëshminë e *F. B.* Prokurori po ashtu nuk ka propozuar që procesverbali të konsiderohet si i lexuar.⁸ Sipas Nenit 387 të KPPK-së, gjykata mund ta bazojë aktgjykimin vetëm në fakte dhe dëshmi të konsideruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rezultat, gjykata nuk mund të mbështetet në Procesverbalin e Dëshmitarit të Dëgjuar, të datës 22 dhjetor 2008, para Prokurorit Publik të Qarkut Xhevdet Bislimit, ku përfshihet dëshmia e *F. B.* Kjo është pavarësisht që *A. B.* ka dëshmuar që pasi ka lënë gruan e tij *A. D.* në tokë në qendrën mjekësore, ai ka hyrë në veturën e *F. B.*⁹

Është mendimi i trupit gjykues që deklaratat e dëshmitarëve të referuar më lart vazhdimisht identifikojnë që në mëngjesin e 18 shtatorit 2008 i Akuzuari ka sulmuar fizikisht gruan e tij Palën e Dëmtuar *A. D.* në qendrën mjekësore, e ka hedhur në tokë dhe i ka lidhur litarin rreth qafës së Palës së Dëmtuar. Deklarimi fajtor i të Akuzuarit më tutje mbështetet nga dëshmia e paraqitur nga Prokurori Publik.

Raportet

c. **Raporti Forenzik Identifikues**, Njësia Regjionale e Forenzikës, Mitrovicë, numri i dosjes nr. , KPS , i datës 18 shtator 2008, thotë që më 18 shtator 2008, rreth orës 10:00, Njësia Regjionale Forenzike ishte informuar rreth incidentit në qendrën mjekësore në fshatin *S.* . Sipas Raportit, në korridorin e shtëpisë së shëndetit dhe në një dhomë kishte njolla të kuqe, që dyshohej të ishin gjaku i viktimës; afër derës, në të majtë, një litar,

⁷ Intervista e dëshmitares *G. G.* para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr. 2008- , 18 shtator 2008

⁸ *Shih* Procesverbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 30 qershor 2010, pp.11, 12 (procesverbali në gjuhën angleze)

⁹ Intervista e *A. B.* para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr. 2008- , 19 shtator 2008, faqe 3 (në përkthimin anglisht)



rreth një metër e 80 centimetra (1.80 m) i gjatë, ishte gjetur që dyshohej të ishte përdorur për kryerjen e veprës.

Raporti thotë që rreth orës 12:00 Njësia Regjionale e Forenzikës është larguar nga vendi i kriminit dhe ka shkuar në Stacionin e Policisë në Vushtri. Në Stacionin e Policisë në Vushtri kanë marrë rrobat e *A. D.* – një mantel të bardhë, një shall dhe një palë këpuca nga Oficeri Shaban Salihu. Aty kishte njolla, dyshohej të ishte gjaku i viktimës, në mantel dhe në shall.

Albumi Fotografik, nr. , i datës 18 shtator 2008, nga Njësia Regjionale e Forenzikës, KPS , përmban fotografi që tregojnë: njollat, që duken gjak, në korridorin e qendrës mjekësore (fotot nr. 6,7,16); njollat, që duken gjak, në dhomën e qendrës mjekësore (fotot nr. 13,14,15,16,17,18,19,20,22,23); litari në dysheme të qendrës mjekësore (fotot nr. 14,15,16,17,18,21); manteli me njolla, që duken gjak (fotot nr. 25,26) shalli me njolla, që duken gjak (foto nr. 27); litari me flokë rreth tij dhe me njollë në litar që duket gjak (fotot nr. 29,30).

Prandaj, Raporti Forenzik Identifikues, me Albumin Fotografik, për më tepër e mbështesin deklarinimin fajtor të të Akuzuarit. Ai përmban dëshmi, që identifikojnë që Pala e Dëmtuar ishte sulmuar në qendrën mjekësore, Pala e Dëmtuar kishte marrë lëndime, dhe njollat që dyshohet të jetë gjaku i saj janë gjetur në dysheme në qendrën mjekësore. Kjo mbështet deklaratën e të Akuzuarit që ai e ka përdorë litarin dhe e ka shtrënguar litarin rreth qafës së Palës së Dëmtuar.

d. **Raporti Hetues mbi Vendin e Ngjarjes**, i datës 19 shtator 2008, konfirmon që njollat, që dyshohet të jenë gjaku i viktimës, ishin në korridor të qendrës mjekësore; në dhomën e qendrës mjekësore kishte edhe më shumë njolla; po ashtu litari ishte gjetur në dhomën e qendrës mjekësore. Sipas informatave të mbledhura nga Oficerët, viktimja e veprës ishte *A. D.* , dhe i dyshuari ishte *A. B.* .

Po ashtu sipas **Raportit Fillestar/të Incidentit**, rasti nr. 2008- , nr. i referencës 2008- , të datës 18 shtator 2008, ishte dyshuar të ketë kryer veprën penale të Tentim Vrasjes, në qendrën mjekësore në Fshatin *S.* . Viktimja e veprës ishte identifikuar të jetë *A. D.* .

Incizimi i Vendit të Ngjarjes, Skica nga Oficeri *X* , ka identifikuar vendin e ngjarjes në qendrën mjekësore në fshatin *S.* .



e. Fletëleshimi për *A. D.*, nr. i regjistrimit *...*, nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Neuro-kirurgjike, thotë që *A. D.* ishte pranuar në Klinikën Neuro-kirurgjike më 18 shtator 2008, që është dita e kryerjes së veprës penale. Ajo ishte pranuar për shkak të lëndimeve në kokën e saj. Në klinikë *A. D.* ka qenë me vetëdije, e përgjumur, me bebëza të njëjta. Ajo ka qëndruar në klinikë nga 18 shtatori 2008 deri më 22 shtator 2008.

Është mendimi i trupit gjykues se provat e mbështesin mjaftueshëm deklarinimin fajtor të të Akuzuarit. Provat identifikojnë qartë që në mëngjesin e 18 shtatorit 2008, rreth orës 10:00, i Akuzuari ka sulmuar gruan e tij Palën e Dëmtuar *A. D.* në vendin e saj të punës në qendrën mjekësore në fshatin *S.* Në sulmin ndaj gruas së tij *A. B.*, ka përdorë litarin. Ai e ka hedhur gruan e tij *A. D.* poshtë në dysheme, dhe ka vendosur litarin rreth qafës së saj dhe e ka shtrënguar. *A. B.* e ka lënë gruan e tij të shtrirë në qendrën mjekësore. *A. D.* ka dëshmuar që asaj i ka ardhur vetëdija vetëm në klinikë në Prishtinë. Dëshmitarja *G. G.* ka gjetur *A. D.* në tokë, me fytyrë të nxirë. Vetëm pasi *G. G.* ka bërë titur, *A. D.* ka lëvizur kokën, por nuk i ka hapur sytë. Prandaj, gjendja në të cilën *A. D.* është lënë nga i Akuzuari *A. B.*, ishte sikur ai të kishte provuar ta privojë jetën e gruas së tij *A. D.*, por që nuk kishte pasur sukses. Kjo është pavarësisht asaj që më 19 shtator 2008, *A. B.*, para Shërbimit Policor të Kosovës ka dëshmuar që kur ka parë që barku i gruas së tij po lëvizte ai e ka lënë atë të shtrirë dhe ka ikur nga qendra mjekësore.¹⁰ Pastaj, *A. B.* në seancën e 28 qershorit 2010 është deklaruar fajtor për akuzën e Tentim Vrasjes. Natyra e sulmit mbi *A. D.*, duke i shkaktuar lëndime gjakosjeje, duke e hedhur në dysheme, dhe duke vazhduar sulmin duke e shtrënguar litarin rreth qafës së saj, që është pjesë vitale e trupit, pasqyron që i Akuzuari ka tentuar ta vrasë gruan e tij. Prandaj, trupi gjykues konsideron që deklarinimi fajtor i të Akuzuarit për akuzën e Tentim Vrasjes është i mbështetur mjaftueshëm nga provat.

5.3. Gjendja mendore e të Akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale të tentim Vrasjes

Siç është përmendur më parë, gjatë rrjedhës së procedurës penale është ngritur dyshimi përkitazi me gjendjen mendore të të Akuzuarit. Për këtë arsye është urdhëruar ekzaminimi psikiatrik i të Akuzuarit.

¹⁰ Intervista e *A. B.*, para Shërbimit Policor të Kosovës, rasti nr.2008

e datës 19 Shtator



a. **Raporti i Qendrës klinike Universitare të Kosovës për** *A. B.*, i datës 05 Mars 2010, është përpiluar nga ekspertët, duke u bazuar në urdhrin e gjykatësit Ferit Osmani, të datës 09 shkurt 2010. Sipas Raportit, ekzaminimi i *A. B.* është kryer në Qendrën Klinike Universitare nga 18 shkurti 2010 deri më 05 mars 2010. Raporti thotë që në kohën e kryerjes së veprës së akuzuar penale *A. B.* ka qenë në gjendje të 'paaftësisë së plotë mendore', ai nuk ka qenë i aftë të gjykojë rëndësinë e veprës, apo të kontrollojë veprimet e tij.

Duke marrë parasysh përfundimet e bëra në Raport sa i përket gjendjes mendore të të Akuzuarit në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata ka urdhëruar sqarim të mëtutjeshëm sa i përket gjendjes së tij mendore.

b. **Raporti Shtesë i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për** *A. B.*, nr. i datës 04 qershor 2010, është përpiluar duke u bazuar në urdhrin e Kryetarit të Trupit Gjyqësor, gjykatësit të EULEX-it Charles L. Smith, III, më datë 17 maj 2010. Raporti Shtesë thotë që më 18 shtator 2008, në kohën kur është kryer vepra penale:

- *A. B.* ka vuajtur nga çrregullimi deluzional, që është i karakterit të përhershëm;
- *A. B.* nuk ka mundur t'i kuptojë apo t'i kontrollojë veprimet e veta;
- *A. B.* nuk ka mundur të kuptojë se në fakt ai ishte duke kryer vepër penale;
- Aftësia e *A. B.* për të kuptuar apo kontrolluar veprimet e veta ishte përjashtuar.

Prandaj, siç pason nga Raporti i datës 05 mars 2010 dhe Raporti Shtesë i datës 04 qershor 2010, *A. B.* në kohën e kryerjes së Tentim Vrasjes ka vuajtur nga çrregullimi deluzional, për shkak të të cilit ai nuk ka mundur t'i kuptojë apo t'i kontrollojë veprimet e veta apo të kuptojë që ai ishte duke kryer vepër penale.

Gjykata ka vlerësuar Raportin e datës 05 mars 2010 dhe Raportin Shtesë të datës 04 qershor 2010, nga dëshmitë tjera të përfshira në dosje.

c. **Raporti për Komisionin Mjekësor në lidhje me** *A. B.*, nr. i kartës , nr. i regj. , i datës 05 dhjetor 1989, thotë që *A. B.* ka qenë në Klinikën Neuropsikiatrike në Prishtinë qysh në vitin 1989: nga 11 maji 1989 deri më 26 qershor 1989 dhe nga 08 shtatori 1989 deri më 20 tetor 1989. Diagnoza që është dhënë është _____.



Fletëlëshimi për *A. B.*, nr. i regj. _____, nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Neuropsikiatrike, ka siguruar që i Akuzuari ka qenë në Klinikë nga 16 gushti 2000 deri më 28 gusht 2000. I Akuzuari ishte sjellë nga policia së bashku me anëtarë të familjes për shkak të agresionit dhe sjelljeve jo të qëndrueshme në drejtim të anëtarëve të familjes. Fletëlëshimi thotë që në Klinikë *A. B.* ka qenë shumë agresiv, ka pasur një qëndrim negativ ndaj anëtarëve të familjes, përmbajtje paranoike, gjendje shpirtërore të paqëndrueshme disforike.

Fletëlëshimi për *A. B.*, nr. i regj. _____, nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Departamenti i Psikiatrisë, thotë që i Akuzuari ka qenë në Klinikë nga 12 dhjetori 2007 deri më 15 dhjetor 2007. *A. B.* prapë është sjellë nga policia dhe familja e tij për shkak të rëndimit të sëmundjes e cila është manifestuar me dhunë në familje. Fletëlëshimi në mes tjerash thotë që *A. B.* ka qenë në një gjendje të pa qëndrueshme, duke menduar shpejt, me ide delusive të xhelozisë, referenca dhe dyshime, sa i përket perceptimit, ai ka pohuar halucinacione akustike dhe nuk ka qenë i vetëdijshëm për gjendjen e tij.

Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i përpiluar bazuar në urdhrin e gjykatës të 13 tetorit 2008, thotë që i Akuzuari është trajtuar me vite për çrregullim psikiatrik, i cili është kronik, të përshkruar në episode të lehtësimit, por edhe të rëndimit poashtu, varësisht nëse terapia është përdorë apo jo. Më tutje thotë që 'idetë deluzive që rrjedhin nga baza e patologjisë kanë shpënë te sjellja dhe veprimet, për të cilat pacienti nuk ka gjykim të drejtë'.

Raporti Psikologjik, nr. _____, i datës 20 nëntor 2008, lidhur me *A. B.* thotë që analizat e materialit psikologjik tregojnë një strukturë skizofren-paranoike të personalitetit, vështirësi për kontrollim të vetes; mungesë të një kontrole të duhur psikike – janë karakteristika psikotike.

Duke marrë parasysh raportet e përmendura më lart, është vlerësuar që qysh në vitin 1989 gjendja mendore e *A. B.* nuk ka qenë e mirë, dhe ai është diagnosikuar me _____ . Raportet që pasojnë konfirmojnë që gjendja e tij mendore nuk ka qenë stabile gjatë viteve, dhe ka pasur rëndime. Raportet konfirmojnë që para kryerjes së veprës penale ai ka qenë agresiv ndaj anëtarëve të familjes së tij, dhe ka pasur ide deluzive të xhelozisë, paranojë, halucinacione.

Prandaj, është mendimi i trupit gjykues që gjykata mund të mbështetet në përfundimet e bëra në Raportin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, nr. _____, të datës 05 mars 2010, dhe Raportin Shtesë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për



A.B., nr. , të datës 04 qershor 2010, - që më 18 shtator 2008, në kohën e kryerjes së veprës penale të Tentim Vrasjes, A.B. ka vuajtur nga çrregullimi deluzional, dhe për këtë ai nuk ka pasur aftësi për të kuptuar apo kontrolluar veprimet e veta apo për të kuptuar që ishte duke kryer vepër penale.

VI. KONKLUDIMET MBI LIGJIN DHE FAKTET PËRKITAZI ME PËRGJEGJËSINË PENALE

A.B. është deklaruar fajtor për akuzën e Tentim Vrasjes. Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar që A.B. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e deklarimit fajtor. Gjykata po ashtu ka verifikuar që A.B. ka bërë deklarimin fajtor vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me Avokatin e tij Mbrojtës.¹¹ Prandaj, trupi gjyqësor konsideron që deklarimi fajtor i përmbush kushtet e kërkuara në Nenin 315, Paragrafi (1) Pikat 1) dhe 2) të KPPK-së.


Pastaj, duke u bazuar në vlerësimet e dëshmisë që është bërë më lart, është konkluduar që deklarimi fajtor i A.B. mbështetet me faktet e lëndës të përfshira në Aktakuzë dhe nga dëshmia sipas Nenit 315, Paragrafi (1) Pika 3) të KPPK-së. Siç është elaboruar në këtë Aktvendim më lart, dëshmia identifikon që më 18 shtator 2008, rreth orës 10:00, në qendrën mjekësore në fshatin S. , A.B. ka sulmuar fizikisht gruan e tij A.D., duke e grushtuar në kokë dhe fytyrë, e ka hedhur në tokë, ia ka mbyllur gojën dhe pastaj e ka nxjerrë nga xhepi një litar dhe ia ka lidhur rreth qafës. Mënyra dhe rrethanat në të cialt është kryer akti identifikon që A.B. ka tentuar ta privojë nga jeta gruan e tij A.D.

Prandaj, është vendosur që A.B. ka kryer vepër penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së.

Megjithatë, Neni 11 Paragrafi (1) i KPPK-së parasheh që një person është përgjegjës penalisht nëse ai apo ajo është i aftë mendërisht dhe është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.

Prandaj, për të shpallur A.B. penalisht përgjegjës për veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me nenin 20 të KPPK-së, kërkohet që A.B. në kohën e kryerjes së Veprës Penale të ketë qenë mendërisht i aftë.

¹¹ Procesverbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 28 qershor 2010, faqe 5 (Procesverbali në Gjuhën Angleze)



Sipas Nenit 12 Paragrafi (1) të KPPK-së një person i cili ka kryer një vepër penale konsiderohet mendërisht i paaftë nëse në kohën e kryerjes së veprës penale, ai apo ajo ka vuajtur nga një sëmundje e përhershme apo e përkohshme, çrregullim mendor apo turbullim në zhvillimin mendor që e ka dëmtuar funksionimin mendor të tij apo të saj që ai person nuk ka qenë i aftë t'i kuptojë apo kontrollojë veprimet e veta apo të kuptojë që ai apo ajo ishte duke kryer vepër penale.

Raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për *A. B.*, i datës 05 mars 2010, dhe Raporti Shtesë i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nr. , i datës 04 qershor 2010, thotë që më 18 shtator 2008, në kohën e kryerjes së veprës penale të Tentim Vrasjes, *A. B.*, ka vuajtur nga sëmundja mendore e çrregullimit deluzional, që është e karakterit të përhershëm, dhe për shkak të të cilit ai nuk ishte në gjendje të kuptojë apo të kontrollojë veprimet e tij apo të kuptojë që ai ishte duke kryer vepër penale.

Prandaj, është vendosur që *A. B.* ka kryer veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së në gjendje të paaftësisë mendore.

Prandaj, *A. B.* nuk është penalisht përgjegjës për veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së, sipas Nenit 11 Paragrafi (1) dhe Nenit 12 Paragrafi (1) të KPPK-së.

VII. MASA E APLIKUESHME E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK

Pasi është vërtetuar nga gjykata që *A. B.* ka kryer Tentim Vrasjen, në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK, në gjendje të paaftësisë mendore, trupi gjykues më tutje ka konsideruar aplikimin e masës sipas Rregullores së UNMIK-ut NR. 2004/34.

Sipas Seksionit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34, masat që mund të imponohen në kryerësin që ka kryer vepër penale ndërsa në gjendje të paaftësisë mendore apo në gjendje të kapacitetit të zvogëluar mendor janë:

- Trajtim të detyrueshëm mendor dhe mbajtje në një institut të kujdesit shëndetësor (trajtim i detyrueshëm psikiatrik në mbajtje); apo
- Trajtim i detyrueshëm psikiatrik në liri.



Më tutje Seksionet 4 dhe 5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004.34 sigurojnë bazat për imponimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në mbajtje (Seksioni 4) dhe në liri (Seksioni 5).

Dallimi për bazat për imponimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në mbajtje (Seksioni 4) dhe në liri (Seksioni 5) është që Seksioni 4 kërkon që për të imponuar trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në mbajtje, një veprë penale të jetë kryer nga autori është e dënueshme me së paku tre (3) vjet burgim. Bazat tjera për të dy llojet e masave janë të njëjta, dhe janë të diskutuara më tutje:

E para, ekziston rrezik serioz që kryerësi do të kryejë një veprë penale që përfshin një akt të dhunës apo shkaktim të dëmit trupor në një person tjetër.

Dëshmitarët ekspertë Ass. Dr. *M. M.*, psikiatër dhe *D. D.*, neuro-psikiatër nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në shqyrtimin gjyqësor të datës 30 qershor 2010 kanë konfirmuar që *A. B.*, në kohën e kryerjes së Tentim Vrasjes dhe gjithashtu aktualisht vuan nga çrregullimi deluzional, që është sëmundje e përhershme dhe ka kohëra të mira dhe të këqija. *A. B.*, kryesisht ka deluzione që e kanë pushtuar atë me xhelozë dhe ndjenjë të madhësisë dhe të persekutimit.¹² Dëshmitarët ekspertë, poashtu, konfirmojnë që është e mundur që *A. B.*, mund të përsërisë veprën e dhunshme apo të shfaqë shenja tjera të dhunës.¹³

Është vlerësuar nga trupi gjyqësor që provat në dosjen e lëndës tregojnë që para kryerjes së Tentim Vrasjes më 18 shtator 2008, *A. B.*, ka qenë agresiv ndaj anëtarëve të familjes së tij. Kjo është cekur në Fletëlëshimin e *A. B.*, nr. i regj. , nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Klinika Neuro-psikiatrike, po ashtu në Fletëlëshimin e *A. B.*, nr. i regj. , nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Departamenti i Psikiatriisë, ku po ashtu është siguruar që keqësimi i sëmundjes së tij është manifestuar me dhunë në familje. Raporti i Ekspertizës i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, i përfshirë bazuar në urdhrin e gjykatës të 13 tetorit 2008, thotë që i Akuzuari 'është trajtuar me vite për çrregullim psikiatrik, që ka qenë kronik, i përshkruar me episode të lehtësisimit por edhe të keqësisimit, varësisht nëse terapia është përdorur apo jo'. Më tutje thotë që 'idetë deluzive që burojnë nga patologjia bazike shpiejnë te sjellja dhe veprimi, për të cilin pacienti nuk ka gjëkim të drejtë'. Raporti Psikologjik i Qendrës klinike Universitare të Kosovës nr. , i datës 20 nëntor 2008, lidhur me *A. B.*, thotë që analizat e materialit psikologjik tregojnë një strukturë skizofrene paranoike të personalitetit, vështirësi në kontrollin e vetes; mungesë të kontrollit të duhur psikik.

¹² Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 30 Qershor 2010, faqe 5 dhe 6, (Procesverbali në Gjuhën Angleze).

¹³ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 30 Qershor 2010, faqe 8, (Procesverbali në Gjuhën Angleze)



Duke pasur parasysh të përmendurat më lart, mendimi i trupit gjykues është që ka rrezik serioz që *A.B.* do të kryejë veprë penale që përfshin një akt të dhunës apo shkaktim të dëmit trupor në një person tjetër.

E dyta, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik është i domosdoshëm për të mënjanuar këtë rrezik.

Dëshmitari ekspert Ass. Dr. *M.M.*, psikiatër, nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në shqyrtimin gjyqësor të datës 30 qershor 2010 ka konfirmuar që *A.B.* ka nevojë trajtim psikiatrik. Ai po ashtu ka konfirmuar që nëse *A.B.* nuk i përmbahet planit të trajtimit psikiatrik gjendja e tij do të përkeqësohet.¹⁴ Sipas Raportit të Ekspertizës të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të përpiluar bazuar në urdhrin e gjykatës të 13 tetorit 2008, gjendja e *A.B.* ka qenë kronike, e përshkruar me episode të lehtësisimit dhe përkeqësimit, varësisht nëse terapia është përdorur apo jo. Gruaja e *A.B.*, *A.D.*, ka dëshmuar që *A.B.* ka marrë mjekim për sëmundjen e tij për herë të parë në vitin 1989. Kur *A.B.* nuk i përmbahej terapisë, sjellja e tij ishte e keqe.¹⁵ Ajo gjithashtu pajtohet që *A.B.* ka nevojë për trajtim, dhe se nëse *A.B.* nuk merr ndonjë trajtim pas gjykimit, sjellja e tij nuk do të jetë e mirë.¹⁶


Prandaj, duke pasur parasysh të lartpërmendurat, dhe veprën serioze penale, Tentim Vrasje, të cilën është përcaktuar që e ka kryer *A.B.*, është vlerësuar nga Trupi Gjyqësor që, për të mënjanuar rrezikun që *A.B.* të kryejë një veprë penale që përfshin një akt të dhunës apo shkaktim të dëmit trupor në një person tjetër, është i nevojshëm trajtimi i detyrueshëm psikiatrik.

Trupi gjykues është i mendimit që *A.B.* ka shfaqur një rrezik të lartë në tentimin e privimit të jetës së gruas së tij *A.D.*. Provat në dosjen e lëndës, siç janë elaboruar më lart, tregojnë që *A.B.* jeton së bashku me gruan e tij. Pavarësisht faktit që nga viti 1989 *A.B.* ishte diagnostikuar me sëmundje mendore, nuk ka shënime që *A.B.* ka ndjekur trajtim të rregullt psikiatrik. Fletëlëshimi, nr. i regj. , dhe Fletëlëshimi, nr. i regj. , tregojnë që *A.B.* ishte vendosur në Klinikë për disa ditë dhe pastaj ishte liruar prapë. Në bazë të Fletëlëshimit, nr. i regj. , pas tri ditëve në klinikë, *A.B.* është larguar. Ai ishte sjellë në klinikë nga policia dhe familja e tij për arsye të përkeqësimit të sëmundjes së tij e cila është

¹⁴ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 30 Qershor 2010, faqet 6, 8 (Procesverbali në Gjuhën Angleze)

¹⁵ Procesverbali i Shqyrtimit Gjyqësor, 28 qershor 2010, faqe 9, (Procesverbali në Gjuhën Angleze)

¹⁶ Procesverbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 28 qershor 2010, faqe 9, (Procesverbali në Gjuhën Angleze)



manifestuar me dhunë në familje. Pavarësisht nga pranimi në Klinikë dy herë, *A. B.*, siç është vërtetuar në Aktvendimin më lart, më 18 shtator 2008 ka sulmuar gruan e tij dhe ka provuar ta vrasë atë.

Prandaj, trupi gjyqësor është shumë i dyshimtë që trajtimi i detyrueshëm psikiatrik i *A. B.*, në liri do ta parandalojë *A. B.* për të kryer akt dhune prapë apo shkaktimin e dëmit trupor ndaj një personi tjetër. Deri më tash nuk është dëshmuar që është e mundur të kryhet trajtimi i *A. B.*. Prandaj, gjykata do të shqiptonte trajtim të detyrueshëm psikiatrik në mbajtje. Sipas Seksionit 3.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2004/34, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në mbajtje mund të kryhet vetëm në një institucion të kujdesit shëndetësor. Aktualisht në Kosovë nuk ekziston një institucion i kujdesit shëndetësor ku mund të kryhen trajtimet e detyrueshme psikiatrike në mbajtje. Dëshmitari ekspert, kur ata propozuan planin e trajtimit për *A. B.* në liri, ata po ashtu konfirmuan që propozojnë një plan kësajsoj, sepse nuk ka institucione të kujdesit shëndetësor në Kosovë. Për këtë arsye gjykata nuk është në pozitë të shqiptojë trajtim të detyrueshëm psikiatrik në mbajtje, sepse nuk ekzistojnë institucione të kujdesit shëndetësor ku trajtime të tilla mund të kryhen, siç parashihet në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/34.

Prandaj, gjykata, në vend të kësaj, shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, sipas Seksionit 5 dhe Seksionit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34.

Në shqyrtimin gjyqësor dëshmitarët ekspertë kanë përshkruar planin e trajtimit psikiatrik për *A. B.* i cili do të ekzekutohet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë. Dëshmitari ekspert Dr. *D. D.* ka rekomanduar që *A. B.* t'i kalojë dy (2) deri tre (3) muaj në Klinikë, me një terapi të garantuar aty. Trajtimi i detyrueshëm në liri është propozuar për shkak të mungesës së institucionit të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, dëshmitari ekspert nuk ka mundur të konfirmoj që do të ishte e mundur të pranohet *A. B.* në Klinikë në kohën e tanishme. Sipas dëshmitarit ekspert Dr. *D. D.*, nevojiten deri katër (4) javë për pranimin e *A. B.* në Klinikë dhe më së miri do të ishte për *A. B.* të fillojë trajtimin më 01 shtator 2010, pasi disa mjekë janë në pushime.¹⁷

Duke marrë parasysh mendimet e cekura të dëshmitarëve ekspertë, gjykata, prandaj, vendos që:

- Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të kryhet në liri në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë; dhe

¹⁷ Procesverbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 30 Qershor 2010, faqe 1,11 (Procesverbal i në Gjuhën Angleze)



- Duke filluar nga 01 shtatori 2010 *A. B.* të pranohet për trajtim të shtrirë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë.

Siç është vërtetuar nga gjykata në këtë Aktvendim më lart ekziston rrezik serioz që *A. B.* do të kryejë një vepër penale që përfshin një akt të dhunës apo shkaktimit të dëmit trupor një personi tjetër. Poashtu është vlerësuar që *A. B.* jeton së bashku me gruan e tij dhe siç është përcaktuar nga gjykata në këtë Aktvendim, *A. B.* më 18 shtator 2008 ka tentuar ta vrasë gruan e tij. Prandaj, në mënyrë që të mënjanojmë rrezikun të cilin *A. B.* mund ta shkaktojë, është vendosur nga gjykata që:

- *A. B.* urdhërohet të lajmërohet për trajtim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë më 01 korrik 2010;
- Deri më 01 shtator 2010, *A. B.*, të kryejë trajtim ambulator në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, me mbikëqyrje të rregullt dhe të afërt të psikiatrit.

Është vlerësuar nga trupi gjykues që masat e cekura më lart janë më të mirat të mundshme për gjykatën në mënyrë që të parandalohet rreziku nga ana e *A. B.*, në mungesë të institucionit të kujdesit shëndetësor, sipas kërkesave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/34.

Prandaj, duke marrë parasysh të gjitha të cekurat më lart, është vendosur si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

Gjykata do të monitorojë kryerjen e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri siç është shqiptuar kundër *A. B.* sipas Seksionit 26.1 të Rregullore së UNMIK-ut 2004/34.

SHPENZIMET

Për arsye që *A. B.* është përcaktuar të mos jetë penalisht përgjegjës për vepër penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së, sipas Nenit 103 Paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 99 Paragrafi (2) Nënparagrafi 1 deri te 5 të Kodit, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe pagesën dhe shpenzimet e nevojshme të avokatit mbrojtës, dhe po ashtu shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit do të paguhet nga burimet buxhetore.




KËRKESA PASURORE JURIDIKE

Nuk është ushtruar ndonjë kërkesë pasurore juridike nga Pala e Dëmtuar *A.D.* .
Megjithatë, nëse do të ishte ushtruar ndonjë kërkesë pasurore juridike, gjykata do të ishte e obliguar të refuzojë atë, sepse *A.B.* është vendosur të jetë penalisht i pa përgjegjshëm për veprën penale të Tentim Vrasjes në kundërshtim të Nenit 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P Nr. 02/2009

Kryetar i Trupit Gjykses:

Charles L. Smith, III
Gjykatës i EULEX-it



Këshilltare Juridike:

Zane Ratniece
Zyrtare Ligjore EULEX-it

Anëtarë të Trupit Gjykses:

Hajnalka Veronika Karpati
Gjykatëse e EULEX-it

Klaus Jung
Gjykatës i EULEX-it

KËSHILLË JURIDIKE: Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij Aktvendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë brenda tetë (8) ditësh nga data e marrjes së kopjes së Aktvendimit, sipas Seksionit 12.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/34.